

Njoftim për shtyp: Google do të nisë udhëtimin në rrugët e Shqipërisë për shërbimin "Pamje rrugësh"

Google njoftoi sot se do të nisë udhëtimin nëpër Shqipëri për të përmirësuar "Hartat e Google" dhe për të mbledhur pamje për shërbimin e tij të mirënjohur "Pamje Rrugësh". Nga 29 prilli, automjetet e Google do të fillojnë udhëtimin dhe shkrepjen e fotografive 360° nëpër qytetet e medha si Tiranë, Durrës, Sarandë, dhe neper zonat turistike e historike te Shqipërisë.

"Pamje Rrugësh" është një shërbim shumë i mirënjohur i "Hartave të Google" i cili u hodh në qarkullim në maj të vitit 2007 dhe ofrohet tashmë në 76 shtete. Shërbimi u mundëson përdoruesve të zbulojnë si dhe përshkojnë në menyre virtuale lagje të ndryshme, me anë të fotografive panoramike në nivelin e rrugëve. " Pamje Rrugësh" ofrohet gjithashtu edhe nga apl. "Toka me Google" si dhe nga "Hartat e Google" për pajisje celulare".

Ne planifikojmë të nisim udhëtimin tonë në Tiranë dhe së shpejti, të vijojmë edhe me qytetet dhe fshatrat e tjera, duke nisur me qytetet më të mëdha dhe vendet më interesante nëpër Shqipëri. Në tërësi, ne synojmë të mbulojmë sa më shumë që të jetë e mundur nga rrjeti rrugor brenda muajve të ardhshëm. Oraret aktuale të udhëtimit varen shpesh nga faktorë që janë jashtë kontrollit tonë (moti, mbyllja e rrugëve etj.). Prandaj, ne do të ofrojmë përditësime të vazhdueshme për vendin ku ndodhen makinat tona - si dhe të dhëna të tjera për shërbimin "Pamje rrugësh" në përgjithësi - në faqen tonë <https://www.google.com/maps/streetview/explore/> menjëherë sapo të nisim udhëtimin tonë.

Imazhet e mbledhura do të përpunohen dhe shkrihen së bashku ndërkohë që ky proces teknologjik mund të zgjase disa muaj. Ato do të ofrohen në një datë të mëvonshme te shërbimi "Pamje rrugësh" ose te "Hartat e Google".

"Kemi dëgjuar nga shumë prej përdoruesve tanë në Shqipëri se mezi presin ta përdorin shërbimin "Pamje Rrugësh". Prandaj, sot jemi shumë të lumtur që ju njoftojmë për nisjen e udhëtimit si dhe për zbulimin e rrugëve dhe pikave më të bukura të Shqipërisë, për përdoruesit tanë anëmbanë botës. Kompanitë dhe përdoruesit shqiptarë do të përfitojnë gjithashtu nga te mirat e këtij shërbimi", thotë Antony Mcloughlin, Menaxher i Shërbimit "Pamje Rrugësh" të Google.

"Kam kënaqësinë që Google do të fillojë projektin Google Street View për Shqipërinë. Street View do të shërbejë për të pasur një mundësi më të mirë në informacionin vizual të bukurisë së qyteteve tona, bregdetit dhe maleve, do të shërbejë për promovimin e zhvillimit të turizmit në Shqipëri, si dhe do të prezantojë trashëgiminë tonë kulturore aq të rëndësishme. Gjithashtu ky mjet do t'ua bëjë

jetën e përditshme më të lehtë qytetarëve shqiptarë, duke u dhënë informacion të saktë mbi destinacionet, planet e udhëtimit, vendet me interes për t'u vizituar etj. Qeveria Shqiptare ka dhënë mbështetjen e saj në këtë nismë, e cila do të implementohet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë." - thote Milena Harito, Ministër Shteti për Inovacionin dhe Administratën Publike.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale mirëpret Google Street View në Shqipëri. Zyra e Komisionerit ka bashkëpunuar në mënyrë të vazhdueshme me përfaqësuesit e Google Street View me qëllim që aktiviteti i përpunimit nëpërmjet këtij aplikacioni të realizohet në përputhje me legjislacionin e mbrojtjes së të dhënave personale dhe respektimit të të drejtave të shtetasve shqiptarë në kuadër të mbrojtjes së privatësisë."Ne e konsiderojmë një mundësi të re për eksplorimin në privatësi." - thote Besnik Dervishi Komisioner i Mbrojtjes të të Dhënave Personale.

Google bën të pamundurën për të mbrojtur privatësinë, ndërsa u mundëson të gjithë përdoruesve të përfitojnë më të mirën nga ky shërbim. Ashtu si me the gjitha imazhet e shërbimit "Pamje rrugësh", përpara publikimit, Google bën mjegullimin e fytyrave dhe të targave të automjeteve në mënyrë që të mbrojnë privatësinë e njerëzve. Pasi fotografitë bëhen publike, njerëzve u jepet mundësia përsëri që t'i raportojnë fotografitë për mjegullim të mëtejshëm, duke shtypur te butoni "raporto një problem" në këndin e poshtëm majtas të imazhit. Nga këtu, ata mund të plotësojnë një formular të shkurtër në të cilin duhet të tregojnë fotografinë konkrete që duhet mjegulluar.

Per te perdorur pamjet, kerko per nje vendodhje ne "Hartat Google" per pajisjet telefonike (e disponueshme ne sistemet Android si dhe IOS), dhe perzgjidh opsionin "Street View" per te nisur rrugetimin tuaj 360°.

Mund të kontrolloni restorantin që përpara se të mbërrini atje, mund të bëni plan udhëtimi, të caktoni pika takimi, apo në fund të fundit, të mësoni diçka më shumë mbi gjeografinë. Nëse kërkoni për shtëpi, mund të kurseni kohë duke eksploruar paraprakisht relievin dhe zonën përreth, si dhe duke parë për drejtime udhëtimi me automjet. Gjithashtu, para pushimeve, mund të kontrolloni lehtësisht për vendin konkret në të cilin doni të shkoni si dhe pamjen e hotelit dhe zonave përreth për të përjetuar pushime të bukura.

Edhe kompanitë mund të përfitojnë gjithashtu nga teknologjia "Pamje Rrugësh", duke integruar falas "Hartat e Google" drejtpërdrejt në faqen e tyre te internetit, si prsh për t'i ndihmuar në reklamimin e ndonjë zinxhir hotelesh ao per te perhapur flalen per ndonje bibliotek apo restorant aty afer. Për informacione të mëtejshme

mbi shërbimin "Pamje Rrugësh" si dhe mënyrën se si mund te perdoret për qëllime argëtimi nga perdoruesit e thjeshte apo dhe nga bizneset, ju lutem vizitoni faqen: <https://www.google.com/maps/streetview/understand/>